

STATUTI

I Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "FIRST CLASS ALBANIA" shpk

Personat që firmosin si më poshtë:

- Fatlum KURMEKAJ, shtetas shqiptar, lindur me datë 06.02.1995, në Bajram Curri, Tropojë dhe banues në Tiranë, mbajtes i dokumentit të identifikimit me ID J50206081W.
- Erdi BELBA, shtetas shqiptar, lindur me datë 13.06.1992, ne Pezë të Madhe, Tiranë dhe banues ne Tiranë, mbajtes i dokumentit të identifikimit me ID J20613063W.
- Ardit KURMEKAJ shtetas shqiptar, lindur me datë 07.12.1997, në Tiranë, dhe banues në Tiranë, mbajtes i dokumentit të identifikimit me ID J71207045M.

Në baze te Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtaret dhe Shoqëritë Tregëtare ", krijojnë Statutin e këtij subjekti, përkatesisht Shoqërisë.

KREU 1

Themelimi, Forma, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.

Neni 1

Data e Themelimit, Forma, dhe Themeluesit.

- (1) Sot me datë 01 Shtator 2022, themeluesit, përkatesisht; Fatlum KURMEKAJ, Erdi BELBA dhe Ardit KURMEKAJ, kanë vendosur, të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipa Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare ", dhe aktet e tjera nënligjore që janë në fuqi. Shoqeria është një person juridik Shqipetar, i cili do të ushtrojë aktivitetin privat në Territorin e Republikës së Shqipërise, pas regjistrimit ne QKB.
- (2) Themelues të Shoqerise janë;
- Fatlum KURMEKAJ, shtetas shqiptar, lindur me date 06.02.1995, në Bajram Curri, Tropojë dhe banues në njësine bashkiake nr 6, Tiranë, mbajtes i dokumentit të identifikimit me ID J50206081W.
 - Erdi BELBA, shtetas shqiptar, lindur me datë 13.06.1992, ne Pezë të Madhe, Tiranë dhe banues ne Tiranë, mbajtes i dokumentit të identifikimit me ID J20613063W.
 - Ardit KURMEKAJ shtetas shqiptar, lindur me datë 07.12.1997, në Tiranë, dhe banues në njësine bashkiake nr 6, Tiranë, mbajtes i dokumentit të identifikimit me ID J71207045M.

Neni 2

Emertimi

Emri i Shoqerise eshte "FIRST CLASS ALBANIA" shpk



FIRST CLASS ALBANIA shpk
TIRANE

Neni 3

Objekti

Shoqëria do të ketë si objekt te veprimitarise së saj si vijon;

- a. Tregëti me shumicë dhe pakicë të mjeteve të transportit të mallrave ose pasagjereve të tonazheve te ndryshme.
- b. Import-Export i mjeteve;
 - Bujqësore (me ose pa zinxhire),
 - Transportit (tokesor),
 - Mjeteve detare me motor,
 - Si dhe import-eksport i pjesëve të këmbimit për tipologjine e mjeteve te sipërcituara.
- c. Transport tokësor mallrash.
- d. Dhenien e mjeteve te transportit të sipërcituara me qira (ditore/mujore) apo me forma te tjera qiradhenje afatgjate si Leasing etj.
- e. Ndërtime civile dhe ekonomike, sistemim dhe asfaltim rrugësh, punime mirëmbajtje dhe restaurimi, sinjalistike rrugore etj.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohezgjatja e Shoqërisë, do të jetë e pakufizuar. Ajo mund të shpërbehet ne çdo kohë me vendim të asamblese se Ortakëve

Neni 5

Selia

- (1). Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen; Zona Kadastrale 8230, ndërtese 1KT, nr Pasurie 7/606, Rruga "Llazi Miho", Nj. Administrative 6,Tiranë.
- (2) Adresa e faqes zyrtare te Internetit eshte: firstclassalbaniashpk@gmail.com.
- (3) Adresa e Shoqerise, per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon; firstclassalbaniashpk@gmail.com.

Neni 6

Shoqëria ka Vulen e saj, ku janë të përcaktuara inicialet e emërtimit te saj, NIPT-i dhe adresa baze.

KREU II

Kapitali

Neni 7

Kapitali Themeltar

Kapitali fillestar, njëkohësisht dhe Kapital Themeltar i Shoqërisë është; 2000000 (dymilion) leke, perkatesisht ne 3 (tre) kuota, me vlere nominale perkatesisht 1300000 leke njëra kuote, me vlere nominale 400000 leke kuota tjeter, si dhe kuota e trete me vlere 300000 leke.

Kapitali Themeltar përbëhet nga kontribute ne vlere monetare shuma 2000000 lekë.

Neni 8

FIRST CLASS ALBANIA shpk
TIRANE

Pjesëmarja e Themeluesve ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise eshte ne përputhje me kontributet e meposhtme;

- Ortaku Fatlum KURMEKAJ, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë te pergjithshme, 1300000 (njemilionetreqindmije) leke, që përbën 65 % te Kapitalit Themeltar te Shoqërisë.
- Ortaku Erdi BELBA, zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 300000 (tre qindmijë) leke, që përbën 15 % te Kapitalit Themeltar te Shoqërisë.
- Ortaku Ardit KURMEKAJ, zotërues i nje kuote me vlerë te pergjithshme 400000 (katërqindmijë) lekë, që përbën 20 % te Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

Neni 9

Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit.

Kapitali i Shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar per kontributet ne para dhe kontributet ne natyre, gje e cila arrihet nëpërmjet emërimit ne rruge ligjore te nje eksperti te autorizuar, për keto kontribute sipas kereses se paraqitur nga nje person i autorizuar nga te gjithe ortaket.

Ne asnje rast, shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e Shoqërise.

Zvogelimi I Kapitalit, lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e Statutit.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortaket në të njëjtën masë ndaj pjesave të kapitalit që përfaqesojne.

Neni 10

Transferimi I Kapitalit

Kuotat e Kapitalit ne nje Shoperi me Pergjegjesi te Kufizuar, si dhe te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen, apo kalohen nëpërmjet;

- a. Kontributit ne kapitalin e Shoqërise
- b. Shitblerjes
- c. Trashëgimisë
- d. Dhurimit
- e. Çdo menyre tjeter e parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar, jane lirisht te transferueshme ndërmjet ortakëve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne Statut.

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashëgimie.

KREU III

Organet vendimarrese dhe drejtuese

Neni 11

Organet Vendimarre

Asambleja e Ortakeve, është organi i vetem vendimarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim te Statutit, sipas modaliteteve te pëcatuara me ligj.

FIRST CLASS ALBANIA shpk
TIRANE

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është pergjegjese për marrjen e vendimeve për Shoqërine per çeshtjet e meposhtme;

- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqerise.
- Ndryshimet e Statutit.
- Emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe Eksperteve Kontabel te Autorizuar.
- Përcaktimin e shperblimeve per Administratoret, Likujduesit dhe Ekspertet Kontabel te Autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire edhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve per ecurine e veprimtarise.
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesimin e Shoqerise ne Gjykata te të gjitha niveleve si dhe në procedimet e tjera ndaj Administratoreve
- Përfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me Organet e Qeverisjes Qendrore dhe Lokale.
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale për thirrjen dhe zhvillimin e Mbledhjeve të Asamblese së Ortakeve.
- Çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo nga Statuti.

Nje Ortak mund të përfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve, ne baze te nje autorizimi, nga nje Ortak Tjeter, apo nje person i tretë.

Administratori i Shoqerise (ne rastin kur nuk është Ortak), nuk mund të veprojë si përfqaquesues i ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme.

Autorizimi i përfqaqsimit mund të jepet vetëm për një mbledhje te Asamblesë së Përgjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 12

Menyra e thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

- (1) Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet njoftimit me shkrese ose, nese parashikohet nga Statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese, apo me mesazh elektronik duhet te permboje; vandin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites. Ky njoftim duhet t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- (2) Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 te këtij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetëm nëse të gjithë ortaket janë dakort, për te marre vendime pavarësisht parregullsisë.

Neni 13

Kuorumi

- (1) Në rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 (tridhjete) per qind te kuotave.
- (2) Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose për çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87, te ligjit "Për tregëtaret dhe Shoqerite

FIRST CLASS ALBANIA shpk
TIRANE

tregëtarë", ajo mund të marrë vendime te vlefshme vetem, nese ortaket që zoterojne me shume se gjysmen e numerit total te votave, janë te pranishem personalisht, votojne me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te këtij ligji.

- (3) Nese Asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungesës se kuorumi te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 14

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjitheshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjedhimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Asambleja e Përgjitheshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çështje të tjera si:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te experteve kontabel te autorizuar,
- d) Percaktimin e shperblimeve,
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- g) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese,

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet ne QKB duke pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqërisë.

Neni 15

Përjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
 - a) Vleresimin e veprimtarise se tij,
 - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
 - c) Ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria,
 - d) Dhenjen ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesit, ashtu si edhe ortaku qe perfaqeson.

Neni 16

Administrimi

- (1) Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.



FIRST CLASS ALBANIA shpk
TIRANE

- (2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme,sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar anasjelltas. Çdo emerim i bërë ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
- (3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se per gjithshme.

- **Administrator i përgjithshëm**

Të dhenat e identifikimit:
(mbiemrat,emrat,adresat)

dhe specifikimet e nenshkrimit:

— Fatlum KURMEKAJ —————

me ID J50206061W

Atesia; HYESN

Datelindja: 06.02.1995, me adresë Njesia Bashkiake nr 6, Tirane.

- **Administrator**

Të dhenat e identifikimit:
(mbiemrat,emrat,adresat)

dhe specifikimet e nenshkrimit:

— Erdi BELBA —————

me ID J20613063W

Atesia; FATMIR

Datelindja: 13.06.1992, me adresë, Tirane.

Neni 17

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kanë të drejtë dhe detyrohen të:

- Kryejnë të gjitha veprimet e administritmit të veprimitarise tregtare te Shoqërise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
- Përfaqësojnë Shoqerine tregetare.
- Kujdesen për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise.
- Përgatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimitarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se per gjithshme per miratim.
- Krijojne një sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, që kercenojne mbarevajtjen e veprimitarise dhe ekzistencen e Shoqerise.
- Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te Shoqerise, siç parashikohet ne Ligjin per Qëndren Kombetare te Regjistrimit.
- Raportojne perpara asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te veçante per veprimitarine e Shoqerise tregtare.
- Kryejne detyra te tjera te percaktuara me ligj dhe me statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:

FIRST CLASS ALBANIA shpk
TIRANE

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive , te cilat kane nje vlore me te larte se 20 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak, pasuri qe kane vlore me te larte se 20 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme, mund te shkurtoje administratorin, ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e Administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore te punes, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne Fuqi.

Neni 18

Pergjegjesia e e administratorit

Administratori eshte perjegjes individualisht, ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja, qe i sjellin dem Shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat ekonomike perkatese.

1. Përveç sa ështe parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 te ligjit " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare ", administratori detyrohet:
 - a. Te kryeje detyrat e tij te percaktuara me ligj dhe ne statut, me mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke l kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesid.
 - b. Te ushtroje kompetencat qe i njihen me ligj dhe me Statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
 - c. Të vleresoje me perjegjesi çështjet per të cilat merret vendim.
 - d. Te parandalpje dhe menjanoje rastet e konfliktit , prezent, apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise.
 - e. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, perqigjet ndaj Shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise Tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer me mirebesim.
3. Nese, Administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte I detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal, qe ata apo, personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt, e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte



FIRST CLASS ALBANIA shpk
TIRANE

kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj Shoqerisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet e shkaktuara nese, ne kundershtim me dispozitat e Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 "Për Tregëtaret dhe Shoqerite Tregëtare", kryen veprimet e meposhtme:

- U kthen ortakeve kontributet
- U paguan ortakeve interesa apo dividente
- U shperndan aktivet e Shoqerise
- Lejon qe Shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur ne baze te gjendjes financiare, duhet te parashikohej qe Shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
- Jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te njekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise perfshire edhe demshperblimin financier, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te pengoje ngritjen e kerkesa padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV

Viti finanziar – ekspertet

Neni 19

Viti finanziar

Viti finanziar i shoqerise fillon me date 1 Janar dhe perfundon me date 31 Dhjetor. Perjashtimi, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 20

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithesvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar per gatit reportin me shkrim per nxjerjen e rezultatit te bilancit financier vjetor si dhe ate per kotrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe reale ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejttes vendimore qe ka.

Neni 21

Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohe zgjatja e parashikuari ne themelimin e saj,
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve,
- c) me hapjen e proceduarave te falimentimit,



FIRST CLASS ALBANIA shpk
TIRANE

d) nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimitarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
e) me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise,duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likujdim e siper".Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaketr nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve,brenda 20 diteve pas prishjes,cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates,per te caktuar nje likuidues.

Neni 22

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet,bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve,ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjt 9901 date 14.04.2012 "per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te pote me kete statutdhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te bazohen dispozitat e ligjt "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti,si dhe per vdo mosmarreveshje qe mund te linde mes Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqipetare.

**ORTAKET
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Fatlum KURMEKAJ



Erdi BELBA



Ardit KURMEKAJ

